



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.37/2018
Prishtinë, më 17.7.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Liburn Aliu, Mimoza Kusari-Lila, Muharrem Nitaj, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, Hykmete Bajrami dhe Memli Krasniqi, anëtarë.

I ftuar: z. Kreshnik Gashi, kryesues i bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).

Pjesëmarrës: Ilir Imeri, Rrezarta Ajeti, Fatmir Gërvalla dhe Nazim Rahimi – ARKEP, Gentian Berbati – KDI, Liridon Gashi – SEEF, Fitore Sopjani – KRK praktikante, Gurakuq Kastrati dhe Doruntina Shala- Hoxha – MTI, Berita Abazi dhe Blerim Sallahu – VV.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Veton Raci dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10 dhe 11.7.2018;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017;
4. Diskutim lidhur me Projektligjin nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit;
5. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Kryetarja i shprehi mirëseardhje anëtarit të rij të këtij komisioni deputetit Muharrem Nitaj.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10 dhe 11.7.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 10 dhe 11.7.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017

Kryetarja theksoi se kemi në shqyrtim Raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe kemi të ftuar kryesuesin e bordit të ARKEP-it, z. Kreshnik Gashi, që të prezantojë punën e këtij Autoriteti. Në vazhdim kryetarja parashtrroi disa pyetje për përfaqësuesit e ARKEP-it, si vijon: A ka ndonjë kompetencë të cilën ARKEP për çfarëdo arsye nuk është duke e kryer? A keni bërë krahasim lidhur me vëllimin e punëve dhe kompetencave që kanë Autoritetet homologe, krahasimin me buxhetin e sektorit që rregullon si dhe me buxhetin e shtetit ku vepron ai Autoritet homolog? A mund të na sqaroni më shumë rreth aktiviteteve për autorizime dhe konfirmime të njoftimeve? A ka shkuar sipas dinamikës së paraparë zbatimi i kodit 383 dhe a ka përfunduar ky proces deri më 1 qershor 2018? A po shfrytëzohen maksimalisht resurset frekuencore? A ka ende resurse frekuencore të pashfrytëzuara? A ka shfrytëzim ilegal të resurseve frekuencore? Cilat kanë qenë pengesat që nuk janë adresuar sfidat lidhur me menaxhimin e resurseve frekuencore, dhe si mendoni t'i adresoni në të ardhmen? A mund të na jepni detaje se cilat janë gjetjet nga monitorimi dhe cili është kualiteti ekzistues i shërbimeve të komunikimeve elektronike? A mund të na sqaroni natyrën e ankesave dhe ankesat a ndërliken me operatorin e njëjtë apo me cilët operatorë më shumë dhe po ashtu do të ishte mirë të dimë se në favor të cilës palë janë zgjidhur ankesat? Sa është niveli i intensitetit të fushës elektromagnetike nga stacionet transmetuese dhe si ndikon në rrethinë? Siç shihet në raport, më tepër ka inspektime në sektorin postar, se sa në sektorin e shërbimeve të komunikimeve elektronike! Pse është e nevojshme më tepër të bëhen inspektime në sektorin postar, se sa në sektorin e shërbimeve të komunikimeve elektronike? Kryetarja për të prezantuar Raportin dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve ia dha fjalën z. Gashi.

Kreshnik Gashi, kryesues i bordit të ARKEP-it, duke prezantuar raportin e punës theksoi se Raporti vjetor i punës përveç se afron të dhëna mbi punën e ARKEP, po ashtu përmban një pasqyrë të plotë të zhvillimeve dhe trendëve në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, si dhe të dhënat thelbësore për aktivitetet e rregulluara në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në Republikën e Kosovës. Po ashtu pjesë e këtij raporti është edhe raporti financiar i ARKEP për vitin 2017 së bashku me raportin e Auditorit. Arritjet kryesore të punës së ARKEP gjatë vitit 2017 janë si vijon: ARKEP ka përmbyllur procesin e shqyrtimit të kërkesave të operatoreve për shërbimet IMT për përcaktimin e kapaciteteve të resurseve frekuencore në brezin 2100 MHz dhe ka afruar

mundësitë teknike dhe ligjore maksimale për t'ju ndarë resurset frekuencore operatoreve ekzistues; ARKEP ka bërë vlerësimin ekonomik (çmimit) për brezin frekuencor 2100 MHz (Euro/MHz/Pop); në kuadër të vlerësimit ekonomik të gjitha brezeve frekuncore për shërbimet e telefonisë mobile (800, 900, 1800, 2100, 2600 dhe 3400-3800 MHz), ARKEP ka punuar së bashku me projektin mbështetës të BERZH në përgatitjen e konceptit të hapjes dhe ka vendosur që gjatë vitit 2018 të angazhoj konsulencë me qëllim të hapjes së plotë të këtyre brezave dhe rilicencimit të operatorëve aktual në vitin 2019. Në periudhën raportuese janë miratuar disa akte me rëndësi nënligjore. Vlen të ceket se të gjithë operatorët që operojnë në telefoninë fikse në Republikën e Kosovës kanë larguar plotësisht kodin 381 nga përdorimi, si dhe është në proces përfundimtar edhe largimi i kodeve të telefonisë mobile. Po ashtu në bashkëpunim edhe me policinë e Kosovës është arritur që për herë të parë gjatë vitit 2017 të ndërpritet sinjali në Kosovë i të gjithë operatorëve të pa licencuar të komunikimeve elektronike nga i gjithë territori i Kosovës përfshirë veriun e vendit. Në formë statistikore më tutje z. Gashi paraqiti aktivitetet dhe punët tjera të realizuara nga ARKEP. Si çështje me rëndësi ai theksoi se në vijimësi është punuar për të përafruar dhe rumbullakuar kornizën e akteve rregullatore, të gjitha të harmonizuara me paketën rregullatore të Bashkimit Evropian. Shikuar nga prizmi i zhvillimeve në tregun e komunikimeve elektronike, raporti afron evidencë se të ardhurat nga shërbimet e afuara nga rrjetet e komunikimeve elektronike në këtë vit kanë shënuar një ngritje të lehtë, për herë të parë që nga viti 2012 e cila në masë të madhe i atribuohet rritjes së konsiderueshme të të ardhurave nga shërbimet e qasjes në internet. Tarifat standarde të shërbimeve mobile krahasuar me vitin paraprak, rezultojnë me tendencë të reduktimit të tyre, ku nga krahasimet vërehet se reduktime të ndjeshme janë bërë nga ana e operatorëve në veçanti me afrimin shërbimeve në pako të ndryshme në të cilën përfshihen minuta komunikimi dhe qasje në internet kundrejt një tarife fikse. Indikatorët e tregut të shërbimeve postare në vitin 2017, krahasuar me vitin 2016, tregojnë po ashtu një rënie të volumit të përgjithshëm të dërgesave postare. Edhe përkundër rënies së numrit të përgjithshëm të dërgesave postare në vitin 2017, krahasuar me vitin 2016, sektori i shërbimeve postare ka të evidentuar rritje të të hyrave të përgjithshme. Në prezantimin e tij z. Gashi paraqiti sfidat me të cilat ballafaqohet ARKEP, si: Pavarësia dhe kapacitetet e kufizuara buxhetore të ARKEP; Rritja dhe ruajtja e resurseve profesionale të ARKEP; Anëtarësimi në organizatat relevante ndërkombëtare; Zhvillimi i mëtutjeshëm i rrjeteve dhe shërbimeve brezgjëra të komunikimeve elektronike dhe arritja e objektivave të Agjendës Digjitale; Rritja e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike; Avancimi i mëtutjeshëm i mbrojtjes së të drejtave të përdoruesve fundor; Implementimi i mekanizmave që garantojnë mbrojtje të konkurrencës; dhe Implementimi i politikave sektoriale në fushën e shërbimeve postare.

Mimoza Kusari-Lila kërkoi më shumë sqarime lidhur me eliminimin e operatorëve ilegal, dhe pyeti se ku ka mbetur ky proces? Lidhur me zbatimin e kodit 383, ajo potencoi se ka pasur kërkesë nga Telekom i Kosovës që të shtyhet afati për kalim në kodin 383 dhe pyeti se cilët janë hapat e ndërmarrë nga ARKEP-i?

Dardan Sejdiu theksoi se tregu i shërbimeve të internetit ka pasur rritje, ndërsa Telekom i Kosovës që nga viti 2012 ka tregun e njëjtë. Telekom i Kosovës a ka kapacitete që në gjithë territorin e Kosovës të afrojnë shërbime të internetit për qytetarin dhe institucionet?

Kreshnik Gashi, ARKEP, duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve theksoi se Autoriteti ushtron plotësisht kompetencat e tij. Sfidë ka qenë kompetenca në veri të Kosovës, por ajo është zgjidhur pas marrëveshjes për Telekom, dhe tash kompetenca ushtrohet edhe në veri. Sektori postar nuk është zgjidhur ende në pjesën veriore dhe atje operon operatori ilegal. Për telefoni fikse zbatohet kodi 383 në veri ndërsa për telefoninë mobile është shfrytëzuar afati deri më 31 tetor 2018. Operatori Vala është në negociata me MTS për pjesën neveri. Sa i përket numrit të punëtorëve, nëse shohim shtetet e rajonit, si për shembull Mali i Zi dhe Shqipëria që janë të ngjashme me Kosovën, kanë më tepër punëtorë dhe më pak kompetenca se sa Kosova. Kalimi në kodin 383 afati i fundit ka qenë 1 qershor 2018, mirëpo pas kërkesave të IPKO-s dhe Telekomit të Kosovës se kanë nevojë për më shumë kohë për të bërë investimet e nevojshme ky afat është shtyrë deri më 31 tetor 2018. Vlera e investimeve sillet rreth 3 deri 3.5 milionë euro dhe besojmë se do të arrihet afati i synuar.

Dardan Sejdiu pyeti sa a keni ndonjë vlerësim sa do të kushtojë investimi dhe a duhet të hyjmë në marrëveshje të romingut me të gjitha kompanitë?

Ilir Imeri, ARKEP, sqaroi se investimet sillen rreth 3 deri 3.5 milionë euro dhe më shumë lidhen me romingun përkatësisht marrëveshjet me operatorë të jashtëm, si dhe duhet të ndërrohen SIM kartelat. Operatorët tanë të gjitha marrëveshjet për roming duhet t'i bëjnë prej fillimit, e jo siç ka qenë rasti me Malin e Zi që ka pasur vetëm me modifikuar.

Muharrem Nitaj pyeti se çka ndodhur nëse nuk arrihen të realizohen marrëveshjet për roming deri më 31 tetor të këtij viti kur edhe është afati i fundit për kalim në kodin 383?

Kreshnik Gashi, ARKEP, sqaroi se është një kod i brendshëm teknik i cili përdoret për marrëveshjet lidhur me romingun, dhe kalimi në 383 nuk varet plotësisht nga këto marrëveshje. Ai shtoi se ka ende shumë hapësirë për shfrytëzimin e resurseve frekuencore. Sfidë mbetet mos kalimi i procesit të digjitalizimit të cilin e udhëheq Komisioni i Pavarur i Mediave. Jemi duke e bërë planin detal për brezët frekuencore. Kualiteti i shërbimeve të zërit është monitoruar dhe është brenda kuotave të standardeve për këtë shërbim. Matjet e realizuara të nivelit të intensitetit të fushës elektromagnetike kanë rezultuar se ky nivel është brenda atij të lejuar dhe nuk ka asnjë problem. Kohë pas kohe ka interferenca të radiofrekuencave, por ato identifikohen dhe zgjidhen. Kosova është vendi i vetëm i cili nuk ka një stacion të vetëm të monitorimit të radiofrekuencave për tërë territorin. Shihet se kemi bërë pak inspektime, por kjo nuk do të thotë që nuk janë mbikëqyrë operatorët. Kemi mungesë të numrit të inspektorëve që të bëjmë më shumë inspektime. Pjesa në veri është sfiduese për shërbimin postar sepse ende vepron operatori ilegal. Lidhur me shërbimet universale, ne si rregullator i trajtojmë të gjithë operatorët në mënyrë të barabartë. 86% e shërbimit postar kryhet nga Posta e Kosovës. Duhet të bëjmë një zgjidhje hibride për Postën e Kosovës që të mbështetet për funksionim dhe në të njëjtën kohë të veprojmë në përputhje me direktivat për shërbimet postare.

Dardan Sejdiu pyeti se kush është duke i bërë 5 milionë euro investime në zgjerimin e rrjetit të internetit. Qeveria me tender e zgjeron rrjetin në zona të pambuluara, a është kështu?

Kreshnik Gashi, ARKEP, sqaroi se projekti i MZHE-së ka komponentë tjetër dhe 50% investon operatori dhe 50% MZHE-ja.

Pas debatit, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- I. Miratohet Raporti vjetor i Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) për vitin 2017;*
- II. I rekomandohet Kuvendit që ta miratojë Raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) për vitin 2017;*
- III. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet deputetja Sala Berisha -Shala, kryetare e Komisionit.*

4. Diskutim lidhur me Projektligjin nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit

Kryetarja theksoi se për shqyrtimin e Projektligjit për produkte të ndërtimit e kemi formuar një grup punues të kryesuar nga deputetja Hykmete Bajrami, por grupi punues nuk ka dërguar ndonjë raport. Deputetja Hykmete Bajrami, për shkak të pamundësisë për të marrë pjesë në këtë mbledhje, me email ka kërkuar që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë.

Mimoza Kusari-Lila, sqaroi se me rekomandim të Bankës Botërore departamenti i ndërtimit ka kaluar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, gjithashtu është transferuar edhe stafi i këtij departamenti. Vlerësimi edhe i deputetes Hykmete Bajrami është se me këtë projektligj po krijohet përsëri një mekanizëm shtesë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Ky është kthim mbrapa në proces. Kalimi i departamentit në fjalë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ishte bërë në funksion të krijimit të mjedisit më të mirë për biznes.

Gurakuq Kastrati, MTI, sqaroi se në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ka ekzistuar departamenti i ndërtimit në bazë të ligjit për ndërtimin. Pjesa e Inspektoratit për produkte të ndërtimit ka mbetur në MTI. Pjesa e produkteve të ndërtimit duhet të mbetet në MTI sepse edhe ndërlidhet me Agjencinë e Standardizimit, Laboratorët, Inspektoratin e Tregut. Pra, në MTI mbetet pjesa e produkteve të ndërtimit, ndërsa pjesa e punimeve të ndërtimit ka kaluar në MMPH. Projektligjin e ka përgatitur një ekspert doktor shkence i ndërtimit nga BE-ja, si dhe është vlerësuar si projektligji më i mirë.

Mimoza Kusari-Lila potencoi se mungon mekanizmi kontrollues për materiale të ndërtimit.

Gurakuq Kastrati, MTI, sqaroi se për shembull ashensorët si materiale në treg janë nën përgjegjësinë e MTI-së, ndërsa punimi në objekt është nën përgjegjësinë e MMPH-së. Projektligji është edhe pjesë e Programit për Reforma Ekonomike. Produktet e ndërtimit nuk testohen në treg. Ky treg është në kaos. Priten të angazhohen edhe dy apo tre inspektorë të inspektimit e produkteve të ndërtimit.

Bilall Sherifi theksoi se ky projektligj duhet të procedohet më tutje, sepse ne, si komision nuk mund t'i nënshtrohemi mendimit të deputetëve veç e veç cilido qoftë ai. Projektligjin ta marrë dikush tjetër në kryesim, të shkojë projektligji në seancë dhe le të vendosë Kuvendi.

Muharrem Nitaj theksoi se së pari ta dëgjojmë deputeten Hykmete Bajrami edhe mandej të vendosim si do të veprojmë më tutje.

Liburn Aliu theksoi se vendimin e parë e ka marrë Kuvendi në seancë plenare, dhe është detyrë e jona me kryer punën, me shqyrtuar projektligjin. Ajo çka tha përfaqësuesi i MTI ka kuptim.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Konkluzion

Deputetja Hykmete Bajrami si kryesuese e grupit punues në mbledhjen e ardhshme të japë mendimin e saj lidhur me projektligjin për produkte të ndërtimit.

5. Të ndryshme
Çështjet vijuese.

Dardan Sejdiu propozoi që të ftohet Ministri i Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, të raportojë lidhur me kontratën me Contour Global për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Sejdiu

Kryetarja kërkoi nga komisioni të përkrah angazhimin e një asistenteje për zyrën e saj për shkak të aktiviteteve të shumta të komisionit.

Komisioni e aprovoi kërkesën.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA